



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Nr. 339 Prot

Tiranë, më 29, 10, 2014

VENDIM Nr. 344, datë 15.10.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 15.10.2014, pasi shqyrtoi Raportin Paraprak mbi zbulimin e varreve gjatë zbatimit të projektit "Rikonstruksioni i rrugës hyrëse në Parkun Arkeologjik të Amantias", financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Qarku Vlorë, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

- I. Të miratojë vazhdimin e punimeve në pjesën e projektit që nuk përfshin sipërfaqen e parashikuar për sistemimin e parkimit, nën mbikqyrjen e arkeologëve të DRKK-Vlorë.
- II. Në sipërfaqen e parashikuar për sistemimin e parkimit, të kryhet gërmimi arkeologjik i varreve nga arkeologët e Institutit të Arkeologjisë në bashkëpunim me DRKK Vlorë. Raporti i gërmimit të paraqitet në mbledhjen e rradhës së KKA.
- III. Shpenzimet për gërmim shpëtimin e varreve do të financohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit sipas një marrëveshjeje me Institutin e Arkeologjisë, për kryerjen e tij brenda muajit dhjetor 2014, në vazhdim të projektit "Amantia", për vëzhgim sipërfaqësor dhe gërmime në qytet dhe nekropol, që arkeologët e këtij Instituti po realizojnë në këtë zonë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO